



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. Prot. 2178

Kuçovë më 22/05/2026

NJOFTIM DHE RENDI I DITËS

Vendi :Salla e mbledhjeve, **Ditë:**e Enjte **Muaji:**Maj **Viti:** 2026

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Kuçovë.

Drejtuar: Z/Znj _____

I nderuar këshilltar,

Ju njoftoj se ditën e Enjte date 28.05.2026, ora 11:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Kuçovë zhvillohet mbledhja e radhës së Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari Këshillit në bazë të ligjit 139/2015 (neni 53, pika 4) me këtë rend dite:

RENDI I DITËS:

- ✓ Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak
- ✓ Miratimi i rendit të ditës së Mbledhjes.
- ✓ Paraqitja nga Këshilltarët e çështjeve dhe problematikave të komunitetit.

1. **Projekt-vendim:**“Për miratimin e rregullores së qendrës ditore për personat me aftësi të kufizuar.”
2. **Projekt-vendim**"Për miratimin e projektit për rikonstruktimin e urës në Bardhaj ,Njesia Administrative Lumas.”
3. **Projekt-Vendim:**”Për miratimin e raportit të performancës Bashkia Kuçovë 2025.”
4. **Informacion:**”Mbi gjendjen dhe masat e marra për kanalet ujitës në njesitë administrative të Bashkisë Kuçovë.”
5. **Informacion:**Informacion për cilësinë e furnizimit me energji elektrike për lagjen “11 Janari”, “Polovinë” dhe Gegë” .
6. **Informacion:**”Informacion për shërbimin e pastrimit në Bashkinë Kuçovë dhe Njesitë Administrative.”
7. **Informacion:**”Informacion mbi daljet jashtë nga përdorimi të aktiveve.”

- ✓ Mbyllja e mbledhjes.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK
ALEKSANDËR ZIU



Adresa: Lagjia nr.1, Blloku “T. Skendo”, Kuçovë
Email: bashkiakucope@yahoo.com

Telefon: +35531123306

Web: www.bashkiakucope.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2159/Prot.

Kuçovë ,më 22.05.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. 30 datë 22 / 05 /2026

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË QENDRËS DITORE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR”

Në mbështetje të nenit 54, shkronja “k”, dhe nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore në fuqi për administrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Kuçovë ,

1. Miratimin e Rregullores se funksionimit të Qendrës Ditore për Personat me Aftësi të Kufizuar, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria përgjegjëse për Shërbimet Sociale pranë Bashkia Kocove për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Alda Hodo

DREJTORIA JURIDIKE

Erion PLAKU

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Jolanda LILA

KRYETARI I BASHKISE

Kreshnik HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Prot 2159

Kucove 22/05/2026

Relacion

Drejtuar: Këshillit Bashkiak
Kuçovë

“ PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SE BRENDESHME TE VITIT 2026 TE QENDRES DITORE TE PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR ”

Te nderuar keshilltar !

I nderuar kryetar i Keshillit Bashkiak!

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore në fuqi për funksionimin e shërbimeve shoqërore, paraqitet për shqyrtim dhe miratim Rregullorja e funksionimit të Qendrës Ditore për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Kjo rregullore hartohet me qëllim përcaktimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të qendrës, ofrimit të shërbimeve sociale, edukative dhe rehabilituese për personat me aftësi të kufizuar, si dhe garantimin e respektimit të të drejtave dhe trajtimit dinjitoz të përfituesve të shërbimit.

Miratimi i kësaj rregulloreje synon:

- Përcaktimin e kritereve dhe procedurave të pranimit në qendër;

- Organizimin e shërbimeve sipas nevojave të përfituesve;
- Garantimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve sociale;
- Përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të stafit;
- Sigurimin e bashkëpunimit me familjarët dhe institucionet përgjegjëse;
- Krijimin e një mjedisi mbështetës dhe gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuar.

Rregullorja është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet për shërbimet e kujdesit shoqëror, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe mirëfunksionimin e qendrës ditore.

Për sa më sipër, kërkohet nga Këshilli Bashkiak shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores së Qendrës Ditore për Personat me Aftësi të Kufizuar.

Drejtorja e Shërbimit Social

Jolanda Lila





Republika e Shqiperise

Bashkia Kucove

Qendra Ditore e Personave me Aftesi te Kufizuar

NR. 2160 prot

Kucove me 22 / 05 2026

Miratohet

Kryetari I Bashkise

Z. Kreshnik Hajdari



RREGULLORE E BRENDESHME VITI 2026

E ORGANIZIMIT DHE E FUNKSIONIMIT

TE QENDRES DITORE TE PERSONAVE ME AFTESI TE KUFIZUAR KUCOVE

Baza ligjore e ku eshte mbeshtetur rregullorja e qendres.

Qendra Ditore per Persona me Aftesi te Kufizuar Kucove e zhvillon veprimtarine e saj qe prej vitit 2008 ne zbatim dhe perputhje me ligjin **NR.121/2016** PER SHERBIMET E KUJDESIT SHOQEROR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE si dhe **VENDIMI Nr.518, date 4.9.2018** PER SHERBIMET E KUJDESIT SHOQEROR KOMUNITARE E REZIDENCIAL, KRITERET , PROCEDURAT PER PERFITIMIN E TYRE DHE MASEN E SHUMES PER SHPENZIME PERSONALE PER PERFITUESIT E SHERBIMIT TE ORGANIZUAR. **VKM NR 822, DATE 06.12.2006** PER STANDARTET E SHERBIMEVE TE PERKUJDESIT SHOQEROR PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUARA NE QENDRAT DITORE DHE REZIDENCIALE UDHEZIMI **NR.597, DT 22.12.2017**” PER MIRATIMIN ESTANDARTEVE TE SHERBIMIT TE PERKUJDESJES SHOQERORE ,ASISTENCE SHTEPIAKE PER PERSONAT ME AFTESI TE KUFIZUAR “dhe UDHEZIMI **NR 581.DT.18.12.2017**” PER MIRATIMIN E STANDARTEVE TE PERKUJDESJES SHOQERORE ,ASISTENCE SHTEPIAKE PER TE MOSHUARIT”

DEKLARATA E QELLIMIT

Qendra ditore e personave me aftesi te kufizuar ne bashkine Kucove eshte nje qender publike e perkujdesit shoqeror per ofrimin e sherbimit t editor, sherbimit logopedik dhe sherbim ne familje per persona te moshuar dhe persona me Ak. Kjo qender trajton femij dhe te ritur me probleme te ndryshme te aftesise se kufizuar mneshtetur nga vleresimet dhe diagnozat te percaktuar nga profesionistet perkates si Mjeku Neuropediater, mjeku Neuropsikiater dhe vendim I KMCAP per personat qe jane perfitues te tij

Perfituesit jane pergjithesisht me probleme te shendetit mendor, perfshire crregullime te spektrit autik.

Femij me probleme te zhvillimit logopedik, femij dhe te rritur qe kane nevojte per mbeshtetje psiko-sociale dhe femij qe frekuentojne shkollen normale dhe kan nevojte per mesim mbeshtetes.

Qendra ka karakter social-edukativ dhe per zhvillimin dhe integrimin e te rinjve e femijeve me aftesi te kufizuara ofron aktivitetet mesimore, educative, zhvilluese si dhe aktivitetet argetuese. Sherbimet e ofruara ne qender jane falas.

Qendra ofron sherbim ditor dhe logopedik per 17 persona nga keta 10 jane persona te moshes nga 6-22 vjec qe marin sherbim ditor me terapi individuale duke u mbeshtetur ne nevojen e tyre dhe 7 jan femij te moshes 3-8 vjec qe marin sherbim logopedik per te zhvilluar aftesite gjuhesore. Terapite individuale dhe logopedike zhvillohen me orar te percaktuar 45 min per cdo rast dhe te ndara sipas grupmoshave. Gjithashtu qendra ofron sherbim ne banese per persona te moshuar dhe persona me aftesi te kufizuar te cilet e kan te pamundur marjen esherbimeve ditore komunitare dhe rezidenciale, qe nuk mund te kujdesen dot per veten dhe te ndihmoen nga familjaret e tyre. Qendra eshte e hapur cdo dite te javes nga e Hena ne te Premte .

Misioni

EDUKIM-ZHVILLIM-INTEGRIM PER TE RRINJTE DHE FEMIJET.

Parimet e funksionimit:

qendra funksionon mbi parimet e:

- 1-Barazise dhe mosdiskriminimit
- 2-Respektit dhe dinjitetit njerezor
- 3-Kofidencialitetit
- 4-Perfshirjes sociale

Objektivat e Qendres:

- Te ofroj nje mjedis te sigurt dhe mbeshtetes ku egjihen dhe inkurajohen personat me aftesi te kufizuar te shprehin deshiren, idet, pakenaqesite, ndjenjat etj
- Te nxise besimin dhe pavartesine e PAK
- Te hartoje plane individuale per cdo person sipas nevojave te secilit
- Te rrise shkallen e zhvillimit te aftesive dhe kapaciteteve te femijeve dhe te rrinjeve
- Te jape ndihmen apo sherbimin perkates per cdo te moshuar apo person me ak ne banese.
- Te jap sherbimn logopedik per femij dhe ritur duke nxitur apo zhvilluar aftesite komunikuese.

Target grupet qe marin sherbim ne qender jane:

- Femij me aftesi ndryshe te moshes 6-21 vjeC
- Adult apo te rrinje me aftesi ndryshe
- Femij qe kan nevoj per mesim mbeshtetes pas shkolle
- Femije qe hasin probleme psiko-sociale dhe kam nevoj per mbeshtetje apo keshillim.

Qendra ofron gjithashtu:

Nje kujdes te vazhdueshem ditor I cili fillon qe nga transporti, siguria ne makine, menaxhimi I situatave brenda makines etj,

Ofrim te vaktit te drekes I siguruar nga vete famijla e personit (I japin dicka me vete)

- Ofrimin e sherbimeve sociale dhe rehabilituese
- Terapi zhvillimi individuale dhe ne grup
- Terapi logopedie
- Aktivitete kreative, kulturore, sociale.
- Mbeshtetje psiko-sociale ne forem keshillimi

- Garntohet siguria fizike
- Jepen sherbime per higjenen personale
- Bashkpunim me familjaret
- Sherbim dhe asistence ne banese per te moshuar dhe persona me AK.

Terapite e zhvillimit mbeshketen ne te 5 fushat e zhvillimit te cilat jane:

- Pavartesia praktike,Psikomotorika,Zhvillimi konjitiv ose perceptimi sipas shqisave,Gjuha dhe komunikimi,Konceptet mbi numrat dhe shkronjat.

Kush mund te mare sherbim ne qender ditore kriteret e pranimit?

Qendra ditore e personave ne aftesi ndryshe ne bashkine Kucope ofron sherbim ditor per femije dhe te rritur me aftesi te kufizuar ,femije dhe me probleme te neurozhvillimit,femij te spektrit autik,femij te familjeve me probleme social-ekonomike qe kan nevoj per edukim,mbeshketje psikologjike,sociale,aktivitete te kohes se lire qe nxisin edukimin dhe integrimin e tyre.

Personat me aftesi te kufizuara marin keto sherbime:terapi zhvillimi,terapi logopedie,terapi okupacionale,mbeshketje psikologjike etj.

Perfitojne sherbim:personat me aftesi te kufizuara fizike,mendore ,intelektuale,sensoriale,banore te bashkise Kucope ose njesive administrative perkatese,persona te referuar nga strukturat sociale shendetesore apo arsimore.

Kush mund te mare sherbim ne banese(Familje)?

Sherbimet ne banese jane sherbime shoqerore qe ofrohen ne familje per te moshuar dhe persona me aftesi te kufizuar te cilet e kan te pamundur te kujdesen per veten dhe nuk mund te ndihmoen nga familjaret e tyre dhe kane nevoj per nje sherbim qe nuk ofrohet nga sherbimet komunitare ne territorin ku banojne.

Llojet e sherbimit ne banese qe ofrohen per moshen e trete dhe persona me Ak nga qendra jane:

- Shoqerim tek mjeku I familjes dhe spitale(rekomandime,analiza,receta,matje e parametrave vital,tension,diabetetj)
- Pagesa faturash
- Shoqerime neper institucione te ndryshme
- Pazare te produkteve te shportes
- Asistence ne familje
- Mbushje bombule gazi etj.

Kriteret e pranimit te personave me aftesi te kufizuar ne qender

Kush e referon rastin?

- Prindi
- Kujdestari ligjor I personit
- Mesuesi I shkolles ose kopshtit
- Administratori shoqeror ne nivel vendor
- Sektori I ndihmes dhe perkujdesjes shoqerore ne nivel vendor
- Cdo person tjetër I interesuar

Dokumentat qe dorezohen per pranimin e marjes se sherbimit.

- Kerkesa e depozitur me shkrim nga te intresuarit
- Certifikata e lindjes nga regjistri kombetar I gjendjes civile viti 2010
- Certifikate familjare nga regjistri kombetar I gjendjes civile viti 2010
- Vendim I KMCAp per ata persona qe e perfitojne
- Fotografi e individit 2 cope
- Miratimi I kerkeses per frekuentim nga keshilli bashkiak
- Vlersim nga mjeku Neuropediater apo Neuropsikiater per percaktimin e diagnozes
- Kontrata TIP e lidhur me institucionin
- Pyetesor ne lidhje me dhenien e pelqimit te prindit apo kujdestarit per pranimin e personit ne sherbimin ditor.

Dokumentat qe dorezohen per sherbimin ne familje

- Kerkesa e me shkrim e individit apo familjes ne nevoj per sherbim specifik(kush e referoj rastin dhe cili eshte lloji I sherbimit)
- Karte ID per cdo perfitues
- Proces verbalet pas marjes se cdo sherbimi
- Plan pune
- Anketime perjodike ne forem pyetsori
- Analize ose informacion ne lidhje me shendetin e te moshuarit.

Procedurat per mbrojtjen e personave ne qender.

Ne qender egziston nje rregjister incidentesh ne te cilin do te raprtohet sipas rastit lloji I incidentit dhe zgjidhja qe do te mare duke bashkpunuar me familjaret dhe institucionet perkatese si Sherbimi Social Rajonal, Polici, Shendetesi etj.

Gjithashtu ne qender eshte e pranishme kutia e ankimit e cila hapet nje here ne muaj per te pare ankesat, pelqimet ,sugjerime nga PAK ose familjaret e tyre .

Struktura organizative e qendres

Drejtor	Jolanda Lila
Pergjegjese Pedagogjike	Olta Marini
Terapiste zhvillimi	Ermonela Salianji
Logopediste	Xhesika Hajdaraj
Infermier	Qemal Tafa
Infermier	Olgert Kuraj
Sanitare	Albana Llupo

Të drejtat dhe detyrat e stafit.

1. Drejtori i Qendrës

Detyrat

- Drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë e qendrës.
- Siguron respektimin e legjislacionit dhe standardeve të shërbimeve sociale.
- Menaxhon stafin, ndan detyrat dhe vlerëson performancën.
- Administron buxhetin, dokumentacionin dhe inventarin e qendrës.
- Bashkëpunon me institucione shtetërore, OJF, familjarë dhe komunitetin.
- Merr masa për mbrojtjen dhe sigurinë e përfituesve.
- Organizon trajnime dhe zhvillim profesional për stafin.
- Raporton periodikisht pranë institucionit përgjegjës.

Të drejtat

- Të kërkojë zbatimin korrekt të rregullores së brendshme.
- Të propozojë masa disiplinore ose vlerësuese për stafin.
- Të përfaqësojë qendrën në marrëdhënie institucionale.

- Të kërkojë fonde, pajisje dhe mbështetje për funksionimin e qendrës.
- Të marrë pjesë në trajnime dhe aktivitete profesionale.

2. Përgjegjësja e Qendrës

Detyrat

- Koordinon punën e përditshme të stafit dhe aktiviteteve.
- Ndjek frekuentimin dhe planin individual të përfituesve.
- Mban dokumentacionin administrativ dhe evidencat ditore.
- Organizon aktivitetet sociale, edukative dhe rehabilituese.
- Komunikon me familjarët për ecurinë e përfituesve.
- Identifikon nevojat e përfituesve dhe ia referon specialistëve.
- Siguron zbatimin e orareve dhe disiplinës në qendër
- Harton planin vjetor të punës për personelin dhe e miraston tek titullari
- Administron rregjistrin e ShSSH
- Aministron dhe plotëson dosjet individuale të përfituesve ku përfshihet: historia personale familjare, vlerësime të mjekut specialist, foto të fëmijëve, plani i zhvillimit etj
- Bashkëpunon me stafin. për ecurinë e punës.

Të drejtat

- Të kërkojë bashkëpunim nga stafi për realizimin e detyrave.
- Të propozojë përmirësime në organizimin e shërbimeve.
- Të informohet dhe të marrë pjesë në vendimmarrje për çështjet e qendrës.
- Të trajnohet dhe të përfitojë mbështetje profesionale.

3. Logopedisti

Detyrat

- Vlerëson çrregullimet e komunikimit, të folurit dhe gjuhës.
- Harton plan individual terapie për çdo përfitues.
- Zhvillon seanca logopedike individuale ose në grup.
- Monitoron progresin dhe dokumenton rezultatet.
- Këshillon familjarët për ushtrime dhe ndjekje në shtëpi.
- Bashkëpunon me terapistët dhe stafin multidisiplinar.
- Përdor metoda profesionale sipas standardeve terapeutike.

Të drejtat

- Të ketë ambiente dhe materiale të përshtatshme pune.
- Të kërkojë informacion të nevojshëm për rastet.
- Të propozojë ndërhyrje terapeutike sipas nevojave të përfituesit.
- Të marrë pjesë në trajnime profesionale dhe supervizim.

4. Terapisti i Zhvillimit

Detyrat

- Vlerëson zhvillimin fizik, social, emocional dhe njohës të përfituesve.
- Harton programe individuale rehabilitimi dhe zhvillimi.
- Organizon aktivitete stimuluese dhe rehabilituese.
- Punon për rritjen e autonomisë dhe aftësive të jetës së përditshme.
- Bashkëpunon me familjen dhe ekipin multidisiplinar.
- Monitoron dhe raporton progresin e përfituesve.
- Ndhmon në integrimin social të personave me aftësi të kufizuara.

Të drejtat

- Të përdorë materiale terapeutike dhe mjete ndihmëse.
- Të propozojë metoda të reja pune.
- Të marrë pjesë në trajnime dhe konferenca profesionale.
- Të ketë kushte të sigurta dhe etike pune.

5. Punonjësit e Shërbimit Lëvizës në Banesë për të Moshuarit dhe Personat me Aftësi të Kufizuara

Detyrat

- Ofron shërbime sociale dhe mbështetje në banesë.
- Ndhmon përfituesit në aktivitetet e jetës së përditshme:
 - higjiena personale,
 - ushqyerja,
 - sistemimi i ambientit,
 - shoqërimi në institucione.
- Monitoron gjendjen fizike dhe sociale të përfituesit.
- Informon përgjegjës të problematikave ose raste emergjente.
- Respekton privatësinë dhe dinjitetin e përfituesve.
- Mban evidenca për shërbimet e ofruara.
- Bashkëpunon me familjarët dhe institucionet përkatëse.

Të drejtat

- Të punojë në kushte të sigurta dhe me mjete pune të përshtatshme.
- Të marrë orientim dhe trajnim profesional.
- Të refuzojë detyra që cenojnë etikën ose sigurinë personale.
- Të mbështetet nga institucioni për rastet e vështira sociale.

Detyrime të përgjithshme për të gjithë stafin

- Të respektojnë etikën profesionale dhe konfidencialitetin.

- Të trajtojnë përfituesit me dinjitet dhe pa diskriminim.
- Të mbrojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.
- Të zbatojnë standardet e sigurisë dhe mbrojtjes sociale.
- Të raportojnë çdo rast abuzimi, neglizhence ose dhune.
- Të bashkëpunojnë në mënyrë profesionale me ekipin dhe familjarët.

DETYRAT E SANITARES

1. Mirëmbajtja dhe higjiena e ambienteve

- Kryen pastrimin e përditshëm të ambienteve të qendrës:
 - klasave,
 - korridoreve,
 - tualeteve,
 - kuzhinës,
 - ambienteve të përbashkëta.
- Dezinjekton sipërfaqet, pajisjet dhe materialet e përdorura nga përfituesit.
- Siguron higjienën sipas standardeve të mbrojtjes shëndetësore.

TË DREJTAT E SANITARES

- Të punojë në kushte të sigurt dhe higjienike.
- Të pajiset me materiale dhe mjete pune të nevojshme.
- Të pajiset me masa mbrojtëse personale:
 - doreza,
 - maska,
 - uniformë,
 - detergjentë dhe dezinfektantë.

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga institucioni përgjegjës dhe është e detyrueshme për të gjithë stafin.

Drejtori I Qendres

Jolanda Lila

Përgjegjësja e Qendres

Olta Marini



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. 2157 Prot.

Kuçovë, më 22 / 05 / 2026

PROJEKT – VENDIM
Nr. 31 Date 22 / 05 / 2026

PER
MIRATIMIN E RAPORTIT TE PERFORMANCES BASHKIA KUÇOVË 2025

Me propozim te Kryetarit te Bashkise. bazuar ne nenin 33, nenin 54 pika k dhe ne nenin 64 pikat c dhe d te ligjit nr.139/2015 date 27.12.2015 “Per veteqeverisjen Vendore”, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe ne zbatim te Udhezimit te Agjensise se Mbeshtetjes se Veteqeverisjes vendore “Per sistemin e monitorimit dhe raportimit te performances se njesive te veteqeverisjes vendore” ,

PROPOZON

- Miratimin e Raportit te Performances te Bashkise Kucove 2025;
- Adresimin e ketij Raporti te strukturat aktuale te bashkise Kucove.
- Publikimin e Raportit te Performances Bashkia Kucove 2025 ne faqen zyrtare te bashkise
- Ky Vendim hyn ne fuqi menjehere

Koordinatori i Performances

Adriatik CARKA

Sekretare e Keshillit Bashkiak

Alda HODO

Drejtor i Drejtorise Juridike dhe MBNJ

Erion PLAKU

Kryetari i Bashkise

KRESHNIK HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr.Prot 2156

Kuçovë, më 22/05/ 2026

Lënda: Relacion mbi Miratimin e projektit për rikonstruksionin e urës në Bardhaj, Njësia Administrative Lumas.

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK

KUÇOVË

Të nderuar,

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 dt. 30.07.2018 “ Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetë qeverisjes vendore”, Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit nr.9, dt. 20.03.2018, Bashkia Kuçovë kërkon miratimin e projektit për rikonstruksionin e urës në Bardhaj, Njësia Administrative Lumas.

Bashkia Kuçovë ka aplikuar për këtë investim pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, pas daljes së rezultateve ky projekt nuk është shpallur fitues. Në këto kushte, për të lehtësuar jetësën e banorëve në këtë komunitet Bashkia Kuçovë kërkon miratimin e projektit sipas projekt vendimit të paraqitur në Këshillin Bashkiak.

Pakësimi i planit të shpenzimeve për projektet: Studime dhe projekttime si dhe Përmirësim i banesave për familje në nevojë, bëhet për shkak se kontratat janë lidhur më pak se vlera e miratuar në buxhetin e vitit 2026.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtor i financës dhe Buxhetit

Heroina Shkemi

Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Sokol Vasili

KRYETARI I BASHKISË

Kreshnik HAJDARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

Nr. Prot 2158

Kuçovë, më 22/05/ 2026

Lënda: Dërgim informacioni mbi daljet nga përdorimi të aktiveve.

Drejtuar: KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Të nderuar,

Në zbatim të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik", nga komisioni i inventarizimit fizik të aktiveve për vitin 2025 i ngritur me Urdhër të Brendshëm nr. 313 datë 10.11.2025 dhe nr. 10 datë 19.01.2026 u krye inventarizimi fizik i aktiveve dhe në përfundim u dorëzuan fletët e inventarit dhe relacioni i inventarizimit fizik të aktiveve në datë 19.01.2026.

Bazuar në relacionin i inventarizimit fizik të aktiveve dhe listën e aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, komisioni i vlerësimit i ngritur me Urdhër të Brendshëm nr.49, datë 20.02.2026 kreu vlerësimin fizik të aktiveve duke dokumentuar këtë proces nëpërmjet proces verbalit, relacionit dhe listës së aktiveve të vlerësuara më dt. 04.03.2026.

Komisioni për nxjerrjet jashtë përdorimit i ngritur me Urdhër të Brendshëm nr.50, datë 20.02.2026, bazuar në listën e materialeve të vlerësuara për jashtë përdorimit, verifikoi asetet përcaktoi mënyrën e asgjësimit dhe asetet që do të shiten për skrap, sipas procesverbalit, relacionit dhe listës së asetëve dt. 19.03.2026.

Bazuar në dokumentacionin e të tre komisionëve, Kryetari i Bashkisë miratoi daljet jashtë përdorimit të asetëve me Vendim nr. 08 datë 19.03.2026.

Asetet e vlerësuara për tu shitur për skrap janë bërë hyrje në magazinë, pasi të ndahen sipas llojit të metalit nga komisioni që do të ngrihet për këtë qëllim, do të shiten në ankand për skrap. Bashkëlidhur gjeni listën e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Kreshnik HAJDARI

Drejtoresh e Financës

Heroina Shkëmbi



REPublika e Shqipërisë
Bashkia Kuçovë
Kryetari

Kuçovë, më 17/03/2026

Prot. 1288

V E N D I M
Nr. 08, dt. 19.03.2026
PËR

MIRATIMIN E DALJEVE NGA PËRDORIMI TË AKTIVEVE

Në bazë të:

- Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Sektorin Publik",
- Relacionit të inventarizimit fizik të aktiveve datë 19.01.2026,
- Procesverbalit të verifikimit dhe vlerësimit fizik të aktiveve, datë 04.03.2026,
- Relacionit të komisionit të vlerësimit për materialet e propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit, datë 04.03.2026,
- Listës së aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit,
- Procesverbalit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, datë 19.03.2026,
- Relacionit të komisionit për nxjerrje jashtë përdorimit, datë 19.03.2026,
- Listës së aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit,

VENDOSA:

1. Të nxirren jashtë përdorimit të gjitha materialet dhe pajisjet e përfshira në listën analitike të komisionit për nxjerrje jashtë përdorimit, të cilat janë konstatuar të amortizuara, të dëmtuara ose jashtë funksionit, përfshirë:
2. Automjeti i Policisë Bashkiake dhe automjeti i MNZ tip **Skoda** të trajtohen sipas procedurave të nxjerrjes jashtë përdorimit në përputhje me dispozitat ligjore dhe mungesën e hapësirës për magazinim.
3. Drejtoria përgjegjëse të zbatojë procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të materialeve sipas udhëzimeve të miratuara dhe të mbajë të dokumentuar të gjithë procesin për auditim dhe kontroll financiar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ngarkohet për zbatim Drejtoria e Financës.

Kryetari i Bashkisë
Kreshnik HAJDARI

A: Lagjia nr. 1, Blloku "T. Skendo", Kuçovë, Shqipëri . www.bashkiakucove.gov.al

Lista e Inventarit
per dalje jashtepdorimit(asgjesimi)

Nr	Llog. Inv	PMP	Nr.PMP	EMERTIMI	Njesia	Çmimi	Rek. jashtepdorimit		Menyra e asgjesimit
							Sasia	Vlefte	
1	2	3	4						
1	3271	1	3271	Flamur te vegjel gjerman ,polak,turk	cope	300	3	900	copetim, gproposje
2	3271	1	3271	Flamur Polak	cope	500	1	500	copetim, gproposje
3	3271	1	3271	Flamur te vegjel holl,cek,yog.	cope	200	3	600	copetim, gproposje
4	3271	1	3271	USB kriptografike	cope	6,250	1	6,250	copetim, gproposje
5	2142	2	2142	Kondicioner 18BTU MIDEA	cope	62,000	1	62,000	shitje per skrap
6	2182	2	2182	PC Hpelite 800	cope	38,000	1	38,000	shitje per skrap
7	2182	2	2182	Monitor Led 19"	cope	7,000	1	7,000	copetim, gproposje
8	2184	4	2184	Karrige metalike me veshje gri	cope	13,000	3	39,000	copetim, gproposje
9	2184	4	2184	Karrige druri	cope	2,000	6	12,000	copetim, gproposje
10	2184	4	2184	Foltore	cope	15,000	1	15,000	copetim, gproposje
11	2184	4	2184	Stende informacioni	cope	45,000	1	45,000	copetim, gproposje
12	3274	4	3274	Varese rrobash te salla	cope	1,000	1	1,000	shitje per skrap
13	2185	5	2185	Kompiuter G2Q365J/349-932-676-87	cope	45,000	1	45,000	35,745 shitje per skrap
14	2185	5	2185	Monitor 103NDLS2A944	cope	14,900	1	14,900	11,836 copetim, gproposje
15	2185	5	2185	Kalorifer	cope	13,000	1	13,000	11,410 shitje per skrap
16	3276	6	3276	Makine llogaritese	cope	2,000	1	2,000	copetim, gproposje
17	3276	6	3276	Gershere	cope	100	1	100	shitje per skrap
18	3276	6	3276	Makine kapese 24/6	cope	360	1	360	shitje per skrap
19	2186	6	2186	Printer Kyocera 756525 MFP	cope	96,600	1	96,600	81,438 copetim, gproposje
20	2186	6	2186	Printer All One Ricoh 201	cope	49,000	1	49,000	38,922 copetim, gproposje
21	3277	7	3277	Dosje meshini	cope	900	1	900	copetim, gproposje
22	3277	7	3277	Heqese kapsesh	cope	100	1	100	copetim, gproposje
23	3277	7	3277	Makine kapese 24/6	cope	300	2	600	shitje per skrap
24	2187	7	2187	Karrike zyre	cope	4,000	1	4,000	3326 copetim, gproposje
25	2187	7	2187	Njesia PC Hp.nr.4CH521258T,Moni.Acer K202H	cope	61,200	1	61,200	57,632 shitje per skrap
26	2187	7	2187	Swich Netgear	cope	1,590	1	1,590	1,340 copetim, gproposje
27	3277	7	3277	Ventilator	cope	5,000	1	5,000	shitje per skrap
28	3278	8	3278	Bokse	cope	2,500	1	2,500	copetim, gproposje

29 327	8	3278	Abazhur varces	cope	1,600	1	1,600	copeitim, groposje
30 327	8	3278	USB 3.0 8GB	cope	4,080	1	4,080	copeitim, groposje
31 327	8	3278	Prize3/3 ml	cope	400	2	800	copeitim, groposje
32 327	8	3278	Prize ballandeze	cope	350	1	350	shitje per skrap
33 327	8	3278	Ventilator	cope	1,600	1	1,600	shitje per skrap
34 327	8	3278	Bokse	cope	2,500	1	2,500	copeitim, groposje
35 327	8	3278	Makine llogaritese	cope	1,600	1	1,600	copeitim, groposje
36 327	8	3278	Prize	cope	500	1	500	copeitim, groposje
37 327	8	3278	Usb 3.0 8GB	cope	4,080	1	4,080	copeitim, groposje
38 327	8	2188	Kalorifer	cope	9,000	1	9,000	shitje per skrap
39 327	8	2188	Karrige rotulluese	cope	8,460	1	8,460	shitje per skrap
40 327	8	3278	USB 2.0 8GB	cope	3,120	2	6,240	copeitim, groposje
41 327	8	3278	Gershere	cope	100	1	100	shitje per skrap
42 218	8	2188	Printer Samsung	cope	12,000	1	12,000	copeitim, groposje
43 218	8	2188	Kompjuter + Monitor	cope	60,000	1	60,000	shitje per skrap
44 327	9	3279	Ventilator	cope	1,500	1	1,500	shitje per skrap
45 218	9	2189	Tavoline pune	cope	21,060	1	21,060	copeitim, groposje
46 218	9	2189	Tavoline kompjuteri	cope	15,300	1	15,300	copeitim, groposje
47 218	9	2189	APC Eosy UPS 700w 230 w	cope	8,512	1	8,512	shitje per skrap
48 214	10	21410	Kondicioner	cope	60,000	1	60,000	shitje per skrap
49 218	10	21810	Printer Lazer	cope	15,500	1	15,500	copeitim, groposje
50 327	10	32710	Makine llogaritese	cope	640	1	640	copeitim, groposje
51 218	10	21810	UPS SPS	cope	5,400	1	5,400	copeitim, groposje
52 327	10	32710	Priza 3/3ml	cope	400	2	800	copeitim, groposje
53 327	11	32711	USB kriptografike	cope	6,250	1	6,250	copeitim, groposje
54 218	11	21811	UPS SPS	Cope	5,400	1	5,400	copeitim, groposje
55 327	11	32711	USB e tokes	Cope	13,700	1	13,700	copeitim, groposje
56 327	11	32711	USB e tokes	Cope	7,800	1	7,800	copeitim, groposje
57 327	11	32711	Meter (50 metra)	Copë	1,442	1	1,442	copeitim, groposje
58 327	11	32711	Switch 16 port	cope	9,600	1	9,600	copeitim, groposje
59 327	12	32712	USB e Tokes	cope	7,800	1	7,800	copeitim, groposje
60 218	13	21813	HP monitor 20"	cope	16,596	1	16,596	copeitim, groposje
61 218	13	21813	PC Dell optiplex 7010 set nr 17789623255	cope	47,088	1	47,088	shitje per skrap
							39,439	shitje per skrap

62	218	Samsung print lazer 2160 kozare	cope	13,000	1	13,000	12,242	I djegur
63	327	Ngrohese 2000 W	cope	4,200	1	4,200		I djegur
64	327	Makine kapese	cope	200	1	200		nuk funksionon
65	327	Tabaka	cope	1,300	1	1,300		e ndryshkur
66	327	Pjata porcelami	cope	200	3	600		te thyera
67	327	Pjalanca qelqi	cope	240	3	720		te thyera
68	327	Mbajtese kancelarie	cope	1,200	1	1,200		e prishur
69	327	Dosje kancelarie	cope	400	1	400		e grisur
70	327	Mbajtese picetash	cope	130	1	130		e thyer
71	218	Printer 1640	cope	12,000	1	12,000		Blok plotesisht i demtuar
72	218	Laptop	cope	41,352	1	41,352	37,241	Board i djegur
73	327	Prize treshe	cope	850	1	850		e shkrete
74	327	Switch	cope	1,700	1	1,700		I djegur
75	327	Ajer ngrohese	cope	2,500	1	2,500		I djegur
76	218	Laptop	cope	51,500	1	51,500	48,048	I demtuar, jashte programit
77	218	Printer all in One Ricoh 3600	cope	45,000	1	45,000	24,750	Blok i demtuar plotesisht
78	327	Makine kapese	cope	900	1	900		nuk funksionon
79	327	Varese Rrobash	cop	6,000	1	6,000		e thyer
80	327	Bokse	pale	2,500	1	2,500		I djegur
81	218	Laptop Hp NB 250GB + Çante	cope	60,648	1	60,648	50,796	I djegur
82	218	Kalorifer	cope	13,000	1	13,000	11,410	nuk funksionon
83	218	PC 4GB 500GB HPP	cope	42,873	1	42,873	38,611	board I djegur
84	218	HP Monitor	cope	16,596	1	16,596	14,946	I djegur
85	327	Ventilator	cope	7,000	1	7,000		nuk funksionon
86	218	Laptop Hp NB 250GB + Çante	cope	60,648	1	60,648	50,796	Board i djegur
87	327	Kosha Plastik 660 lit	cope	24,448	10	244,482		Te djegur,
88	218	Printer All in One Toshiba 413	cope	30,000	1	30,000	25,785	Blloku eshte demtuar plotesisht
89	218	Printer Samsung ML 1665 Kozare	cope	11,000	1	11,000	10,316	I djegur
90	327	Freskuese	cope	1,500	1	1,500		Djegur
91	327	Makine llogaritese	cope	1,800	1	1,800		nuk funksionon
92	327	Makine kapese 24/6	cope	360	1	360		nuk funksionon
93	327	Karocce dore	cope	3,000	1	3,000		thyer, ndryshkur
94	218	Kompjuter INFT 2	cope	48,500	1	48,500	45,672	I vjeter jasht programit
95	218	Monitor ACER 22	cope	23,400	1	23,400	22,036	I djegur
95	218	Led Acer model V193HQVBD	cop	53,835	1	53,835	51,324	I djegur
95	218	Tavoline pune	cop	12,000	1	12,000	10,146	e amortizuar plotesisht
95	218	Karrige	cop	3,960	1	3,960	3,348	e amortizuar plotesisht

96	218	35	21835	Skaner HP FSC 1410	cope	24,600	1	24,600	23,166	copetim, grosposje
97	218	35	21835	PC4GB 500GB HPP	cope	46,467	1	46,467	41,848	shitje per skrap
98	218	35	21835	HP monitor	cope	16,596	1	16,596	14,946	copetim, grosposje
99	215	38	21538	Automjet "BENZ" blu	cope	980,000	1	980,000	980000	shitje per skrap
100	327	40	32740	Pasqyra banjoje	cope	1,500	2	3,000		copetim, grosposje
101	327	42	32742	Ventilator	cope	7,000	1	7,000		shitje per skrap
102	327	42	32742	Priza 3/3ml	cope	400	1	400		copetim, grosposje
103	218	58	21858	Led Acer model V193HQVBD	cop	53,835	1	53,835	50,697	copetim, grosposje
104	218	58	21858	Tavoline pune	cop	12,000	1	12,000	9,683	copetim, grosposje
105	218	58	21858	Karrige	cop	3,960	1	3,960	3,195	copetim, grosposje
106	218	59	21859	Led Acer model V193HQVBD	cop	53,835	1	53,835	50,697	copetim, grosposje
107	218	59	21859	Karrige	cop	3,960	1	3,960	3,195	copetim, grosposje
108	215	90	21590	Automjet Skoda cek	cope	1,200,000	1	1,200,000	1200000	shitje per skrap
109	214	K	214K	Tabo plastike (Sist uji pjishem)	ml	251	777	195,027	164045	copetim, grosposje
110	218	218	2186100	Led Acer model V193HQVBD	cop	53,835	1	53,835	51,324	copetim, grosposje
111	218	218	2181100	Tavoline pune	cop	12,000	1	12,000	10,146	copetim, grosposje
112	218	218	2181100	Karrige	cop	3,960	1	3,960	3,348	copetim, grosposje
		327						402,994		
		214						317,027	286,045	
		215						2,180,000	2,180,000	
		218						1,402,711	1,197,874	
				Totali				4,302,732	3,663,919	

Shenim: mbyllet me numrin rendor 112.

Sinan Likaj

Kryetar

Erion Çela

Anëtar

Petrit Ruka

Anëtar

Persida Koli

Anëtare

Dritan Rrogozi

Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE
DHE MENAXHIMIT TE KONTRATAVE

Nr.Prot 1993/1

Kuçovë, më 18/05 2026

Lënda: Kthim përgjigje

Për dijeni: Kryetari i Bashkisë

Z. Kreshnik Hajdari

Drejtuar:

*Këshillit Bashkiak
Kuçovë*

Të nderuar këshilltarë!

Me shkresë nr.1993 prot, datë 13.05.2026, Këshilli Bashkiak kërkon informacion mbi vlerësimin e punës lidhur me shërbimin e pastrimit, në Bashkinë Kuçovë dhe Njësitë Administrative.

Përsa më sipër ju informojmë se:

Drejtoria e Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit të Kontratave, e ka patur në qëndër të vëmendjes realizimin e detyrave, zërave të punës, volumeve të shërbimit të pastrimit dhe ofrimin cilësor të shërbimit, jo vetëm në qytetin Kuçovë por edhe në njësitë Administrative Kozare, Perondi dhe Lumas, për të eliminuar ndotjen e mjedisit në të gjithë territorin e bashkisë.

Njësia Administrative Kuçovë, zona I

Janë respektuar zërat e punimeve dhe volumet e punimeve në shërbimin e pastrimit, sipas përcaktimeve të bëra në tenderin e hapur të shërbimit të pastrimit në qytetin Kuçovë.

- Sipërfaqja që fshihet me fshese dore është 189 400 m² çdo ditë.

Kjo sipërfaqe është e përcaktuar sipas inventarit të rrugëve të qytetit Kuçovë.

- Çdo ditë kryhet grumbullim e transportim i mbetjeve urbane me mjet teknologjik.

Eshtë një shërbim shumë i rëndësishëm ndaj kemi treguar kujdesin maksimal për ta realizuar sa më mirë.

Për këtë shërbim ne kemi në dispozicion 240 kontenierë të shpërndarë në të gjithë qytetin Kuçovë. Sasia totale shkon rreth 5700 ton/vit mbetje urbane të cilat shkojnë në venddepozitim për trajtim.

-Lagia e rrugëve dhe shesheve me mjet teknologjik në sipërfaqen prej 110 000 m² .

Eshtë një shërbim mjaft i kërkuar nga qytetarët sepse ka të bëjë direkt me përmirësimin e mjedisit. Në këtë shërbim kemi parashikuar rrugët dhe sheshet kryesore të qytetit Kuçovë, të cilat janë me infrastrukturë të mirë.

-Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit, zona I

Eshtë shërbim i domosdoshëm për një qytet të pastër dhe mjedis të shëndetshëm, pasi mos heqja e mbetjeve të tilla ndot mjedisin përreth.

Ka shume qytetarë që i hedhin mbetjet inerte pranë pikave të grumbullimit ose akoma me keq në ambiente publike duke u bërë shkak për ndotjen e mjedisit. Për këtë shërbim ne kërkojmë më shumë mbështetje nga Policia Bashkiake në menyrë që të fenojme këtë fenomen negativ dhe të dëmshëm për shëndetin e qytetarëve.

Për këtë arsye herë pas herë kemi kryer aksione për heqjen e tyre për shkak të sasive të mëdha të hedhura pa kriter si dhe vazhdimisht kemi informuar për hedhjen e tyre në venddepozitim të mbetjeve inerte tek ish Gropat e Bitumit i miratuar tashmë me vendim të Këshillit Bashkiak.

Vlen për tu përmendur edhe investimi me zëvendësimin e 60 konteniere të rinj të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkisë Kuçovë në pikat më të nevojshme, duke rritur cilësinë e këtij shërbimi. Gjithashtu do të kemi shumë shpejt edhe 100 kontenierë të tjerë metalik nëpërmjet të cilëve do rrisim akoma më shumë përmirësimin e këtij shërbimi.

Në Njësinë Administrative Kozare dhe Perondi, zona II

Për këtë shërbim kemi në dispozicion 190 kontenierë të shpërndarë në të gjithë fshatrat e dy njësive njësine ku ofohet ky shërbim. Nuk ka patur problem me punën dhe volumet e punimeve, por kemi patur kërkesa nga banorë të kësaj njësie për shtimin e shërbimit me kontenierë të tjerë.

Deri tani jemi të kufizuar për shkak edhe të mungesës së infrastrukturës rrugore në zonat ku kërkohet shtimi i numrit të kontenierëve. Sasia totale shkon rreth 2585 ton/vit mbetje urbane të cilat shkojnë në venddepozitim për trajtim.

-Heqja e mbetjeve inerte nga pikat e grumbullimit, zona II.

Duhet të kemi parasysh që çdo ditë dalin shumë mbetje inerte, kryesisht mbetje biologjike si barëra, degë peme, perime nga serat si domate, speca, patëllxhanë etj.

Ky është shërbim i domosdoshëm për një bashki të pastër dhe mjedis të shëndetshëm, sepse mos heqja e mbetjeve të tilla ndot mjedisin përreth.

Gjithashtu për këtë njësi kemi probleme si drejtori pasi ka shume banorë që i hedhin mbetjet inerte pranë pikave të grumbullimit, ose akoma më keq në ambjente publike duke u bërë shkak për ndotjen e mjedisit.

Eshtë shërbim i domosdoshëm për një bashki të pastër dhe mjedis të shëndetshëm, pasi mos heqja e mbetjeve të tilla ndot mjedisin përreth.

Në Njësinë Administrative Lumas, zona III

Për këtë shërbim ne kemi në dispozicion 40 kontenierë të shpërndarë në 5 fshatra të kësaj njësie për shkak të infrastrukturës rrugore mujore. Sasia totale shkon rreth 172 ton/vit mbetje urbane të cilat shkojnë në venddepozitim për trajtim.

Synimi jonë është shtrirja edhe më e gjerë e këtij shërbimi në territoret në të cilat nuk ofrohet për shkak të infrastrukturës, rritja e cilësisë së shërbimit për qytetarët. Së fundmi pasi kemi verifikuar në të gjithë territorin një sasi të konsiderueshme kontenierësh të amortizuar për shkak të viteve apo dëmtimeve të tyre, jemi në procedurë për të marrë mbeshtetje nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit me kontenierë të rinj dhe të kryejmë menjëherë zëvendësimin e tyre.

Venddepozitimi i mbetjeve urbane

Sic jeni ne dijeni venddepozitimi i mbetjeve urbane në fshatin Rreth Tapi tashme është i rehabilituar plotësisht me mbeshtetjen e projektit zvicerian SECO sipas standarteve e legjislacioneve në fuqi dhe është marrë në dorezim nga Bashkia Kucove.

Gjithashtu nga ky projekt është përfituar edhe një plan operacional i menaxhimit të mbetjeve, i cili përfshin sistemimin, ngjeshjen, mbulimin me dhe e me cakell të mbetjeve.

Tashme Bashkia Kucove ka nje mjet ne dicpozicion qe punon ne venddepozitim per sistemimin, ngjeshjen dhe mbulimin e mbetjeve urbane sipas te gjitha standarteve te legjislacionit ne fuqi per operimin ne venddepozitime duke e mbajtur ate gjimthone ne kontroll. Puna ne venddepozitim do te vazhdoje rregullisht deri ne ndertimin e lendfillin rajonal te mbetjeve urbane ne qarkun tone.

Vlen per tu permendur se ne vijim iniciativa jonë do të jetë ndarja e mbetjeve në burim, duke filluar me projekt pilot ne rrugët kryesore të qytetit e më pas për tu shtrire më gjerë në territor. Kjo është initiative me fokus uljen e mbetjeve të përziera duke krijuar mundësinë e shitjes së mbetjeve të riciklueshme.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

P/Drejtorinë e Prokurimeve Publike

Ndriçim PIRJA



[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË
DREJTORIA E ZHVILLIMIT RURAL

Nr 1992/1 Prot

Kucove me 18 .05.2026

Informacion : Mbi gjendjen dhe masat e mara per kanalet vaditese ne Njesite Administrative te Bashkise Kucove .

Drejtuar ; Keshillit Bashkiak Kucove

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 “ Per veteqeverisjen vendore” si dhe te kerkeses nga Keshilli Bashkiak me nr. 1992 prot . date 13/05/2026 per informacion mbi gjendjen dhe masat e marra per kanalet vaditese ne Njesite Administrative te Bashkise Kucove ju bejme me dije se Drejtoria e Zhvillimit Rural ka mare te gjitha masat e nevojshme per kete sezon ujitje me qellim ujitjen e tokave bujqesore nga ana e fermereve te kesaj Bashkie . Bashkia Kucove perbehet nga 3 njesi Administrative Njesia Administrative Perondi ,Njesia Administrative Kozare dhe Njesia Administrative Lumas ne te cilat perfshihen dhe skemat ujitese sipas ndarjes territoriale ,

Ne Njesine Administrative Perondi kemi;

Skemen ujitese Diga e Lumit Osum –Perondi me dy kanale ujitese ,Kanali ujitese Balta e kuqe Magjate , me gjatesi 2 km primari dhe 5 km kanale te dyta ,ndersa kanalet e treta jane ne inventar te vete fermereve .Aktualishte kemi mare masa per pastrimin e te gjitha kanaleve te para dhe te dyta sipas kesaj skeme .Krahas pastrimit te kanaleve me mjete mekanike kemi angazhuar edhe fuqine punetore prane bordit te kullimit per pastrimin e urave mbi kanal . prizave dhe te gjitha veprave ne kanal qe nuk behen me mjete mekanike , perfshi dhe sifonin e madh ne kufirin me Lapardhane .Puna vazhdon dhe brenda muajit Maji do te perfundojme te gjitha kanalet ujitese ne kete skeme per te qene te gateshem per fillimin e sezonit te ujitjes . Po keshtu ka perfunduar se pastruari kanali primar ujitese Lapardha –Perondi me gjatesi 3 km dhe 6 km kanale te dyta , ndersa,tercialet jane ne inventar te vete fermereve .Burimi i funizimit me uji eshte Diga e lumit Osum. Me kete skeme, ujitin fshatrat Perondi dhe Magjate me nje siperfaqe prej 250 ha me veterrjedhje , me pagese 400 leke/dy .Gjithesej ne kete skeme ujitese jane 16 km kanale ujitese ne sherbim te ujitjes se tokave bujqesore te cilat jane gati brenda muajit Maj , per te filluar sezonin e ujitjes ne kohe dhe ne sherbim te fermereve sipas kerkesave te tyre .Kjo skeme ujitese u vjen ne ndihme rreth 1000 fermereve qe perfshihen ne teritorin e dy fshatrave Perondi dhe Magjate te Njesise Administrative Perondi.

Skema ujitese e rezervuarit Goraj .

Burimi i funizimit me uji eshte rezervuari Goraj me kapacitet 1.200.000 m3 uji i projektuar , ndersa sot ka 900.000 m3 uji , i mjaftueshem per ujitjen e tokave bujqesore dhe poshte diges se tij ndodhen fshatrat Goraj , Magjate dhe Perondi te cilat perfshihen ne kete skeme ujitese . Te gjitha parametrat e ketij rezervuari jane funksionale . shkarkuesi katastrofik eshte ne gjendje pune dhe funksionon rregullishte , saracineska e shkarkimit eshte funksionale dhe e manovrushme per shkarkimin e ujit per vaditje sipas kerkesave te fermereve .Rezervuari monitorohet nga punonjesi i bashkise . duke hapur saracinesken nje here ne jave me qellim qe te mos bllokohet nga prurjet e ngurta gjate renjes se reshjeve te shiut . Ky rezervuar para 4 vitesh

ka pasur nje carje gjate gjatesise se diges e cila mundet te agravonte me tej situaten .. Per kete arenye nga ana e Bashkise Kucove per kete vit , u realizua nje investim ne digen e rezervuarit , duke e bere ate me te qendrueshme dhe me te sigurte per te mos patur ne te ardhmen pasoja ne rrezikeshmerine e kesaj dige.

Struktura e marrjes se ujit behet nga dy dege kryesore te kanaleve ujitese ,dege e majte dhe dega e djathte e ketij rezervuari .

Dega e majte ka nje kanal te pare rreth 3km ,dega e djathte ka nje kanal prej 8 km dhe ,vetem 10 km kanal jane efektive per te dyja degete qe sherbejne per ujitjen e tokave bujqesore .. Kjo skeme siguron nje siperfaqe ujitese prej 250 ha nga 400 qe ishte e planifikur me pare sipas projektit .Sot sistemi shperndares realizohet nga kanale te para e te dyta ,,ndersa kanalet terciare jane ne inventar te fermereve Po behet pastrimi i kanaleve ujitese si dhe i veprave te artit ne te gjitha gjatesine e tyre duke qene te gateshem per ujitjen e tokave bujqesore , sipas kerkesave te vete fermereve ..Ky rezervuar ka kapacitetin e tij te mjaftueshem per realizimin e kesaj skeme ujitese per te gjitha fermeret qe ndodhen poshte ketij rezervuari

Njesia Administrative Kozare

Skema ujitese e Rez. Gege .

Burimi i funizimit me uji eshte rezervuari Gege me kapacitet 700.000 m3 uji ne kushtet e soteme dhe i mjaftueshem per ujitjen e tokave poshte diges se rezervuarit . Te gjitha parametrat e ketij rezervuari jane funksional dhe te monitorueshem nga ana jone. .

Struktura e marrjes se ujit behet nga dy kanale ujitese ,dega e majte dhe dega e djathte e ketij rezervuari .Dega e djathte ka nje kanal primar te projekyuar 4.2 km dhe me stacion pompimi ,sot nuk funksionon .Dega e majte ka nje kanal me gjatesi 2 km funksionale , kanal i pare dhe vadit nje siperfaqe prej 20 ha .Ne kete skeme egzistojne 2.8 km kanale te dyta dhe terciaret jane inventar te fermereve . Kanali funksional do te pastrohet brenda ketij muaji , duke qene i gateshem per ujitjen e fermereve qe kane mbjelle kultura bujqesore poshte diges se rezervuarit .

Njesia Administrative Lumas

Skema ujitese e rez Belesov

Kjo skeme ujitese nuk funksionon plotesisht , pasi rezervuari i Belesoves ka dale jashte funksionit per ujitje per shkak te mbushjes se tij plotesisht me inerte te ardhura nga perrenjte malore qe derdhen ne kete rezervuar. Duke patur parasysh burimet e ujit nga perroi i Sinetit si dhe perroi i Saraselit te cilet kane sasi uji per nje sezon te pjeseshem do behet pastrimi i kanaleve ujitese qe sherbejne ne gjitha gjatesine e tyre sidomos per fshatrat Pellumbas , Lumas , Bardhaj , Vodez ,dhe Sheqez te cilet gjate pruerjeve te ujit nga keta perrenj do te vadisin pa problem. .Ne kete skeme ujitese jane 12 km kanale kryesore dhe do te jene ne gadishmeri per sezonin e ujitjes brenda muajit maj . Ne kete njesi Administrative vaditet nje siperfaqe toke prej 100ha .

Ne njesine Kozare nuk kemi skema ujitese per shkak se veprat ujitese kane dale jashte funksionit Gjithesej si bashki jane 32km kanale ujitese ne sherbim te fermereve tane te cilet do te jene ne gadishmeri te plot per sezonin e ujitjes .

Edhe per kete vit procesi i vaditjes do te administrohet nga vete Bashkia , ku do te merren edhe punonjes me kontrat ne dy skemat ujitese Perondi , si dhe ne skemat ujitese Lumas e Gege . Me masat qe ka marre Drejtoria e Zhvillimit Rural per kete sezon ujitese premtojne qe ujitja e tokave nga fermeret do te jete pa probleme dhe do ju pergjigjemi ne kohe te gjitha kerkesave te tyre.

Derjtori
Nazmi Suli



1731/1

30.04.2026

Vjellani

OPERATORI I SISTEMIT TE SHPERNDARJES SH.A
DREJTORIA RAJONALE BERAT

Nr. 386, Prot.
11

Berat, me 28.04.2026

Lenda: Kthim përgjigje .

Drejtuar: **BASHKISË KUÇOVË**
KËSHILLIT BASHKISË KUÇOVË

Në përgjigje të shkresës Tuaj, me Nr.Prot.1731 të datës.22/04/2026 me objekt “Kërkesë për informacion”, protokolluar nga Drejtoria Rajonale Berat e Operatorit të Sistemit të Shpërmdatjes Sh.a, me Nr.Prot.386 date 24/04/2026 në vijim ju informojmë/sqarojmë si më poshtë:

Për zonat ku është kërkuar informacion mbi cilësinë e furnizimit me energji elektrike, konkretisht, lagjeve “11 Janari”re , Lgj “Polovinë” dhe fshati “Gegë” furnizimi me energji elektrike realizohet nëpërmjet fdrave fid nr.5/6KV, fid.nr.7/10kV dhe fid. nr.13/6kV të cilët dalin nga N/Stacioni Kuçovë110/35/10/6 kV.

Fideri nr.5/6 kV në total furnizon 25 kabina elektrike ku 19 kabina janë pronësi e OSSH dhe 6 kabina elektrike janë pronë private.

Fideri nr.7/10 kV në total furnizon 21 kabina ku 15 kabina janë pronësi të OSSH dhe 6 kabina janë pronë private.

Fideri nr.13/6 kV ne totale furnizon 23 kabina ku 21 kabina janë pronësi të OSSH dhe 2 kabina janë pronë private.

Në zonën ku shtrihet lagjia 11 Janari dhe lagjia. Polovinë, Bashkia Kucovë ,furnizimi i abonentëve kryhet nga 14 kabina të fiderit nr.5/6kV dhe nga 1 kabinë e fiderit nr.7/10kV.

Në zonën ku shtrihet fshati Gegë , Bashkia Kucovë ,furnizimi i abonentëve kryhet nga 11 kabina të fiderit nr.13/6kV.

Numri i abonentëve të cilët marrin shërbim në furnizimin me energji elektrike nga OSSH në këtë territor është përafërsisht 1250 abonentë.

Rrjeti elektrik në nivel tensioni të mesëm, kabinat elektrike si dhe rrjeti elektrik në nivel tensioni të ulët në këto zona paraqitet në gjendje teknike mesatarisht i mirë.

Në disa segmente linja e tensionit të mesëm, rrjeti shpërndarës i tensionit të ulët si dhe një pjesë e kabinave elektrike paraqitet e amortizuar si rrjedhojë e kohës së gjatë në shfrytëzim.

Nga ana e Drejtorisë Rajonale Berat/Sektorit Teknik Kucovë janë evidentuar problematika në këto zona dhe si rrjedhojë nga punonjësit elektrikist të Grupit Operativ Kucovë në vazhdimësi realizojnë remonte në këto linja TM/TU të tipit të mesëm, profilaksi dhe mirëmbajtje, si ndërrim izolatorësh, shtrirje përcjellesash, drejtime shtyllash, pastrime traseje nga deget e pemëve etj.

Në kabinat elektrike ku janë evidentuar probleme nga ana e Drejtorisë Rajonale Berat/ Grupi Operativ Kucovë janë marrë masa në ndërrimin e transformatorëve të fuqisë duke i vendosur ata me fuqi më të madhe sipas kërkesave të zonës në zhvillim dhe rritjes së ngarkesave.

Janë sistemuar një pjesë e paneleve të tensionit të ulët të cilat dalin nga këto kabina elektrike duke vendosur automate të rinj ,po ashtu në një pjesë rrjetit të tensionit të ulët është vendosur rrjet kabllor abc.

Nga grupet e rregjimit të Sektorit Teknik Kucovë maten sistematikisht ngarkesat dhe nivelet e tensionit të daljeve TU të kabinave elektrike, ku në rastet ku shfaqen rënie tensioni ndërhyhet duke kryer simetrizimin e ngarkesave ose mirëmbajtjen e rrjetit shpërndarës TU duke eliminuar pikat e dobëta të kontaktit të përcjellesve.

Nga ekipet e Grupeve Operative TM/TU për rastet ku janë shfaqur ankesa nga popullata për cilesinë e furnizimit me energji elektrike kanë kryer konstatime duke mundësuar në pjesën më të madhe zgjidhjes të problematikës.

Problematika të shfaqura që hasen në rrjetin shpërndarës OSSH në këtë zonë është se një pjesë e konsiderueshme e furnizimit me energji elektrike përveç abonetëve privat dhe ata familjarë zënë një peshë dhe pushtet e sektorit të naftës. Ku paraqiten mjaft vështirësi në cilesinë sipas standarteve dhe kushteve teknike, pasi bëhen ndryshime të shpeshta të fuqive motorike, si dhe vendosje ose jo në punë të puse të naftës sipas grafikut shfrytëzimit që ka kjo ndërmarje.

Edhe pse merren masa të vazhdueshme në remonte, mirëmbajtje për edhe në eliminimin e avarive, për të pasur një cilësi sa më të mirë dhe një situatë normale në furnizimin e enrgjise elektrike nuk është e mjaftueshme në normalizimin e situatës sipas standarteve teknike.

Në linja TM të gjata që kanë numër të madh kabinash si dhe shtrirje të rrjetit TU nga ana e punonjësve tanë hasen shumë vështirësi për realizimin e tyre duke pasur parasysh kapacitetet të burimeve njerzore si dhe ato logjistike.

Ndaj nga ana e Drejtorisë Rajonale Berat/Dega Teknike harton projekt -preventiva për investime me të tretë.

Konkretisht për zonën që është kërkuar informacion për lagjen 11 Janari, dhe zona që përfshin lagjën Polivinë, Bashkia Kucovë nga ana Drejtorisë Rajonale Berat/Dega Teknike janë përgatitur projektet elektrike për mundësimin e prekjes së investimeve në rrjetin shpërndarës që përfshihet ky teritor me qëllimin e përmirimit ndjeshëm në cilësinë e furnizimit me energji elektrike.

Projektet janë dërguar në qendër pranë Drejtorisë Qendrore Tiranë dhe në pritje të miratimeve të tyre.

Me konsideratë,

DREJTOR I DREJTORISE RAJONALE BERAT

Z.Armand





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË

Nr. Prot. 2156/1

Kuçovë, më 22/05/2026

PROJEKT-V E N D I M

Nr. 32, dt. 22.05.2026

Për miratimin e projektit për rikonstruksionin e urës në Bardhaj, Njësia Administrative Lumas

Në është në zbatim të ligjit nr. 139/2015, dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23 dt. 30.07.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetë qeverisjes vendore", Udhëzimit standard për zbatimin e buxhetit nr.9, dt. 20.03.2018,:

KËRKOJMË:

1. Miratimin e projektit për rikonstruksionin e urës në Bardhaj, Njësia Administrative Lumas:

Shuma në lekë:

Institucioni	Gr- Prog.kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Viti 2026	Viti 2027	Viti 2028
124-2124001	00-06260-05	2310000		Rikonstruksion i urës Bardhaj, Lumas	10,291,566	20,583,134	20,583,134
124-2124001	00-06260-05	2310000		Rikonstruksion i urës Bardhaj, supervizim	813,034		
124-2124001	00-06260-05	2310000		Rikonstruksion i urës Bardhaj, kolaudim	97,564		
Total					11,202,164	20,583,134	20,583,134

2. Pakësim i planit të shpenzimeve:

Institucioni	Gr-Prog.kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Shuma në lekë
124-2124001	00-10661-05	2310000	1240252	Permiresim i banesave ekzistuese per familje ne nevoje	634,644
124-2124001	00-06260-05	2310000	1240239	Studime dhe projektme	573,898
124-2124001	00-01110-05	6090000	9999999	Fond rezervë	9,993,622
Total					11,202,164

3. Shtesë në planin e shpenzimeve për financimin e projektit për rikonstruksionin e urës në fshatin Bardhaj, Njësia Administrative Lumas në vitin 2026:

Institucioni	Gr-Prog.kap	Llog. ek	Kod projekti	Emërtimi	Shuma në lekë
124-2124001	00-06260-05	2310000		Rikonstruksion i urës Bardhaj, Lumas	10,291,566
124-2124001	00-06260-05	2310000		Rikonstruksion i urës Bardhaj, supervizim	813,034
124-2124001	00-06260-05	2310000		Rikonstruksion i urës Bardhaj, kolaudim	97,564
Total					11,202,164

Drejtoria Juridike

Erion Plaku



Drejtoria e Financës

Heroina Shkempi



Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Sokol Vasili



Sek/Këshillit Bashkiak

Alda Hodo



KRYETARI I BASHKISË
Kreshnik HAJDARI

